

KËRKESË
Nr. 1902, datë 24.3.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Për ndërtim kopshtesh dhe ambulancash në territorin e Bashkisë Ura Vajgurore”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Ura Vajgurore.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të çmimeve të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është **156,100 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind) lekë**.

ZËVENDËSMINISTRI I
ZHVILLIMIT URBAN
Alferd Dalipi

Lista e shpronësimeve për projektin "Ndërtim kopshtesh dhe ambulancash në territorin e Bashkisë Ura Vajgurore"

Nr.	Pronar	Përshkrimi	ZK	Nr. Pasurisë	Sip. Totale m2	Lloji i pasurisë		Çmimi Njësi	Vlera e shpronësimit	Konfirmuar ZVRPP-ja
						truall	are			
1	Agron Nazif Lika	Kopësht-ambulancë	2881	475/2	250	250		213	53250	po
2	Rrapush Qerim Mile	Ambulancë	1004	1760/9	650	50		203	10150	po
3	Xhelal Riza Xhelo	Kopësht	1093	1061/17	1400	450		206	92700	po
								Totali	156100	

